



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600181/3

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandohet kryerja e veprimeve përmbarimore konform parashikimeve të nenit 606 të K.Pr.C., në procesin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.*

Drejtuar : **Asaf Stroka**
Kryetar i Zyrës së Përmbarimit

SARANDE

Për dijeni : **Albert Pilo,**
Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit
Gjyqësor.

Llambriola Misto
Sekretare e Përgjithshme pranë Ministrisë së Drejtësisë

H.Ç
Adresa:

TIRANË

Z. Kryetar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit Hektor Çoçoli, në të cilën prezantohet shqetësimi për mosekzekutimin nga ana e organit që ju përfaqësoni, të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Gjirokastrë, me Vendimin nr. 449, datë 28.10.2014, për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr.16, datë 16.07.2014, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me objekt :

“Anullimin e Vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave nr.1125, datë 22.08.2013, të Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave.

Njohjen e së drejtës së pronësisë subjektivit të shpronësuar S.H.Ç dhe kthimin e sipërfaqes prej 1.5/96 pjesë e sipërfaqes totale 11320ha, për sipërfaqen 20.6 ha të ndodhur në Zonën Kadastrale nr.2297 Ksamil, me kufizime (sipas aktit të ekspertimit bashkëngjitur të ekspertit Eshref Liçaj).
Detyrimin e ZVRPP të kryejë veprimet përkatëse”.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, më datë 02.11.2014, Zyra e Përmbarrimit, Sarandë, ka pranuar kërkesën e gjyqfituesit H.Ç, për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv si më sipërpërmendur. Konstatohet se, me Shkresën nr.92, datë 11.11.2014, Zyra e Përmbarrimit, Sarandë, ka lajmëruar ZVRPP, Sarandë, për detyrimin e vendosur sipas vendimit gjyqësor dhe se në referim të parashikimit të nenit 517 të K.Pr.C. ka caktuar afatin 10 ditor për zbatimin në mënyrë vullnetare të detyrimit.

Me rastin e kalimit të afatit për përmbushjen në mënyrë vullnetare të detyrimit të rrjedhur ndaj ZVRPP, Sarandë, konstatohet se, organi që ju përfaqësoni, përmbarruesi gjyqësor i çështjes, nuk ka vijuar kryerjen e veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke mosrespektuar në këtë mënyrë, kryerjen e procedurave përmbarrimore në afatin e vendosur në ligj. Pas më shumë se një viti, në mënyrë të paparashikuar në ligj, ju z.Kryetar, me shkresën nr. 379 prot, datë 19.01.2016, keni rikërkuar ZVRPP, Sarandë, mundësimin e ekzekutimit të detyrimit të vendosur, pra, të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme sikurse përcaktuar në dispozitivin e vendimit gjyqësor.

Referuar parashikimeve të kryera në Kodin e Procedurave Civile, neni 606, veprimi përmbarrimor i radhës që duhet të kryej Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor, është vendosja e sanksionit ndaj debitorit, i cili refuzon, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale.

Qëndrimi i mbajtur prej organit që ju përfaqësoni, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Duhet të dini, se, vepra penale “*Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës*”, parashikuar e dënueshme në nenin 320/a të Kodit Penal, kryhet me mosveprim për mosekzekutimin pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës penale ose civile. Shkaqe të përligjura janë ato të sëmundjes së përmbarruesit, vdekje ose fatkeqësi tjetër familjare ose forcë madhore. Kur mungojnë këto shkaqe të përligjura, personi i ngarkuar ka përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Gjithashtu nisur nga parashikimi i kryer në nenin 31, dhe 35/dh të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor*”, i ndryshuar, gjykojmë se, për qëndrimin e mbajtur prej jush në procesin e ekzekutimit të Vendimit nr. nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, do të mund të marrë nismën për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të përmbarruesit gjyqësor

të çështjes për dhënien e masës disiplinore sikurse parashikuar në nenin 35/dh të këtij Ligji.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi Avokati i Popullit e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Kryerjen e veprimeve përmbarimore sikurse parashikuar në nenin 606 të K.Pr.C. për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit nr.1208, datë 16.07.2014, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, në favor të shtetasit H.Ç.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka